



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

MEMO

Për: Zt. xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx.

Përgatitur Nga: yyyyyyyyyyyyyy

Lënda: Detyrat funksionale të Sektorit të Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputive Bujqësore.

Data: 29.08.2019

Sqarojmë se me miratimin e ligjit nr. 65/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”(i ndryshuar) sektori i inspektimit të mbrojtjes së bimëve në AKU mori disa funksione për inspektimin e subjekteve në zbatim të këtij ligji.

Nga ana e sektorit për kryerjen e detyrave në zbatim të ligjit janë bërë disa korrespondenca me shkresa zyrtare me Ministrinë e Bujqësisë për problematikat e evidentuara në zbatimin e këtij ligji përkatësisht:

- AKU nuk ka të dhëna për prodhuesit e duhanit që prodhojnë gjetheduhani përtrej, mbibazëkontratës së shkruar të prodhimit dhe autorizimit të marrë në MBZHRAU.
- Nuk ka procedurë inspektimi për kontrollin e subjekteve që kryejnë veprimtarinë përkatësisht:
 - **Prodhimin bujqësor të duhanit dhe tregtimi i duhanit të pa përpunuar.**
 - **Tregtimin e duhanit të përpunuar dhe i produkteve të tij.**

Për më tepër nga ana jonë është hartuar lista e verifikimit “Mbi kërkesat për tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij” dhe me anë të e-mali i është dërguar Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimeve.

Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.2423.datë 13.06.2016 u krye miratimi i listës së verifikimit “Mbi kërkesat e përpunimit industrial, dhe/ose prodhimin e produkteve të duhanit, tregtimin të duhanit dhe të produkteve të tij” dhe si rrjedhojë filloj dhe inspektimi i këtyre subjekteve.

Nga ana e Inspektorëve të sektorit në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU janë përgatitur modulet për trajnimin e inspektorëve Rajonal të AKU. Trajnimi i inspektorëve të terrenit dhe PIK janë bërë në dy periudha përkatësisht në vitin 2012, dhe vitin 2014. Trajnimet janë realizuar edhe për sektorin e PIK pasi deri në vitin 2014 sektori i inspektimit ka qenë përgjegjës edhe për inspektimin e importit të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe inuteve bujqësore.

AKU në mënyrë periodike ka informuar MBZHR në lidhje me veprimtarinë për kontrollin e inuteve bujqësore. Më poshtë po Ju pasqyrojmë informacionet përkatëse:

I Nderuar Zoti Ministër,

Krahas veprimtarisë së kontrollit të produkteve ushqimore, AKU i ka kushtuar vëmendje të posaçme edhe kontrolleve zyrtare të operatorët e biznesit që vendosin në treg inputet bujqësore¹, si dhe kontrollin në subjektet e tregimit të duhanit dhe produkteve të tij.

Në tabelën bashkëlidhur (Aneks 1) po përcjellim të dhëna statistikore për inspektimet, procedimet administrative, analizat laboratorike të kryera për këto produkteve në periudhat janar – shtator 2017, tetor – dhjetor 2017 si dhe gjatë këtij gjashtëmujori 2018.

Sikurse shihet nga të dhënat statistikore ka progres të dukshëm në drejtim të kontrollit lidhur me treguesit cilësor të inuteve bujqësore duke impaktuar kështu në garantimin e fermerit shqiptar për to. Kështu nga të dhënat statistikore po veçoj:

1. Ndërsa në periudhën tetor 2017 e në vijim AKU ka kryer shumë më pak kontrolle ndaj subjekteve që tregtojnë inute bujqësore krahasimisht me periudhën **janar – shtator 2017**, numri i shkeljeve të konstatuara dhe masave të marra është dukshëm më i lartë;
 - **Janar – Shtator 2017 janë kryer 4769 kontrolle** dhe ndaj subjekteve të gjetura me shkelje janë marrë masa administrative: **101 paralajmërime , 25 gjoba me vlerë 1 740 000 lekë si dhe janë bllokuar 23.5ton produkte kësisoj (fara dhe plehra)**

¹Produktet e Mbrojtjes së Bimëve (PMB), Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor (MMSHB), dhe Plehrat e Përdorimit për Bimësinë.

- **Tetor 2017 – qershor 2018** janë kryer rreth 1000 inspektime më pak dhe ndaj subjekteve të gjetura me shkelje janë marrë masa administrative: **116 paralajmërime**, **80 gjoha me vlerë 6 890 000 lekë, janë bllokuar 75.4 ton produkte kësisoj (fara dhe plehra), si dhe 23 litra e 60 fidanë.**

2. Numri i analizave për inputet bujqësore kryhet kryesisht sipas planifikimit të miratuar, por gjithsesi ka pësuar rritje në sajë planit shtesë për monitorimin e plehrave si dhe në kuadër të ndjekjes së gjurmueshmërisë për rastet e analizave jokonforme të farërave apo dhe indicieve të ndryshme.

- **Janar – shtator 2017** janë kryer **149 analiza** nga të cilat kanë dal **jo konforme 9 raste**
- **Tetor 2017 – qershor 2018** janë kryer **256 analiza** nga të cilat kanë dal jo konforme **20 raste.**

Nisur nga fakti se ka perceptim publik e madje edhe ankesa të drejtpërdrejta të fermerëve për cilësinë e inputeve bujqësore (e specifikisht të plehrave), atëherë këto rekorde nga përgjigjet e analizave të laboratorëve (jashtë AKU) mendoj që kërkojnë një analizë të posaçme – për kryerjen e të cilës AKU nuk ka mundësi; kështu nëse i marrim të mirëqena ankesat e fermerëve, atëherë në gjykimin tonë janë vetëm dy mundësi teorike

- **Ose ka probleme në analizimin e produktit nga laboratorët**
- **Ose përdorimi i PMB nga fermerët nuk kontrollohet nga asnjë strukturë shtetërore apo private**

Nga të dhënat statistikore gjykoj të vë me theks të veçantë faktin se, **ISUV nuk ka kryer asnjë analizë për produktet e mbrojtjes së bimëve (PMB) në harkun e dy viteve të fundit – çështje të cilën e kemi adresuar specifikisht.**

E çmoj të domosdoshme të evokoj në këtë informacion se gjatë kësaj periudhe nga RASF (sistemi i informimit të shpejtë të BE) kemi patur dy njoftime për ngarkesa të eksportuara nga Shqipëria të cilat janë bllokuar dhe asgjësuar për shkak të nivelit më të lartë se norma e lejuar të pesticideve;

duke e vlerësuar si një alert të fuqishëm që kompromenton eksportet tona, veç ndjekjes së rasteve kemi adresuar deficiencat serioze të DRB lidhur me kontrollin e përdorimit të PMB.

3. Veprimtari të tjera që impaktojnë në efikasitetin e kontrollit dhe mbikëqyrjes ndaj tregtimit të inputeve bujqësore
- a. Është intensifikuar bashkëpunimi ndërinstitucional me institucionet që kanë lidhje të drejtpërdrejta me zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, duke adresuar edhe problematikat në çdo rast.

- një nga problemet e evidentuara ka qene dërgimi me vonesë i rezultatit te analizave nga laboratorit i farërave (ESHFF), për rrjedhojë çështja i është adresuar në rrugë zyrtare² - rezultati: aktualisht përgjigjet e analizave nga ESHFF, vjen brenda afateve duke bërë të mundur vendimmarrjen në kohë reale jo vetëm për subjektin por edhe për vetë produktin.

Tabela nr.1.

Inspektimet dhe masat administrative të marra nga Sektori i Inspektimit të MBIB për periudhën Tetor- Dhjetor 2017, dhe Janar-Qershor 2018

Numri i Inspektimeve	Subjekte tregtimi PMB ³	Subjekte tregtimi MMSHB ⁴	Subjekte tregtimi të plehrave të përdorimit për bimësinë	Subjekte të tregtimit të duhanit e produkteve të tij	totali
Janar – Shtator 2017	1235	1499	1430	605	4769
Tetor – dhjetor 2017	331	452	611	146	1540
Janar – qershor 2018	625	743	647	393	2408

Nr. i masave administrative paralajmërim	Subjekte tregtimi të PMB	Subjekte tregtimi të MMSHB	Subjekte tregtimi të plehrave të përdorimit për bimësinë	Subjekte të tregtimit të duhanit e produkteve të tij	totali
Janar – Shtator 2017	32	8	61	-	101
Tetor – dhjetor 2017	7	1	52	-	60

² nëpërmjet shkresës nr.464 Prot, datë, 19.01.2018

³Produkte për Mbrojtjen e Bimëve

⁴Materiali Mbjellës dhe Shumëzues Bimor

Janar – qershor 2018	17	7	32	-	56
-------------------------	----	---	----	---	----

Nr. i masave administrative gjobë	Subjekte tregtimi PMB		Subjekte tregtimi MMSHB		Subjekte tregtimi të plehrave të përdorimit për bimësinë		Subjekte e tregtimit të duhanit e produkteve të tij		totali	
	nr	vlerë	nr	vlerë	nr	vlerë	nr	vlerë	nr	vlerë
Janar – Shtator 2017	8	1.210.000	9	310.000	7	210.000	1	10.000	25	1.740.000
Tetor – Dhjetor 2017	5	900.000	-	-	23	985.000	1	20.000	29	1.905.000
Janar – Qershor 2018	20	2.270.000	20	2.310.000	10	400.000	1	5.000	51	4.985.000

Nr. i masave administrative bllokim aktiviteti dhe produkti	Subjekte tregtimi PMB	Subjekte tregtimi MMSHB	Subjekte tregtimi të plehrave të përdorimit për bimësinë	Subjekte e tregtimit të duhanit e produkteve të tij
Janar – Shtator 2017	-	3.4 ton farë misri, 9.12 ton f.qepujke.	20.075 ton	-
Tetor –	21 litra	33.99 ton farë	2.23 ton,	1.43 ton

Dhjetor 2017		misri	4600 litra	duhan i grirë
Janar – Qershor 2018	1.85 kg	30.33 ton dhe 60 fidan	7.3 ton	-

Lloji i analizave Janar-Dhjetor vitin 2017	Gjithsej	Konform	Jo Konform
Për PMB	39 mostra te planifikuara	Nuk janë analizuar nga ISUV	-
Për MMSHB	156	134	11
Për Plehrat	89	89	-
Totali	284	223	11

Informojmë se nga ISUV nuk janë analizuar mostrat e PMB-ve të dërguara nga AKU

Lloji i analizave Janar-Maj 2018	Gjithsej	Konform	Jo Konform
Për PMB	17	Nuk janë analizuar nga ISUV	-
Për MMSHB	112	105	-
Për Plehrat	70	70	-
Totali	119	65	7

I nderuar, Zt. Ministër,

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është një nga institucionet përgjegjëse për garantimin e cilësisë së inuteve bujqësore në vend.

Në zbatim të detyrave funksionale AKU kryen kontrole zyrtare në të gjithë operatorët e biznesit⁵ që kanë si aktivitet vendosjen në treg të inputeve bujqësore⁶ me qëllim plotësimin e treguesve cilësor të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Referuar problematikave të parashtruara në takimet e ndryshme me fermerët, këta të fundit janë ankuar për cilësinë e inputeve bujqësore.

Gjithashtu ka një perceptim nga publiku, në raste të caktuara edhe nga mediat, që inputet bujqësore që qarkullojnë në tregun shqiptar janë të një cilësie më të ulët se ato që tregtohen në vendet e BE apo me gjerë.

AKU në zbatim të detyrave funksionale, kryen kontrollet zyrtare periodike dhe merr mostra për analiza zyrtare në subjektet që kryejnë aktivitetin e importit, prodhimit, tregtimit dhe magazinimit të inputeve bujqësore në zbatim të planit vjetor të inspektimeve me bazë risku dhe marrjes së mostrave të miratuar nga Ministri i BZHR.

Por, nisur nga problematikat e evidentuara gjatë inspektimeve të kryera nga DRAKU në terren, sektori i MBIB në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU nuk është mjaftuar vetëm me inspektimet e kryera në zbatim të planit vjetor të inspektimeve, por ka propozuar, hartuar e zbatuar edhe disa Plane Veprimi për MMSHB, PMB por kryesisht për Plehrat e Përdorimit për Bujqësinë.

Vetëm për periudhën janar-dhjetor 2017 janë kryer **gjithsej 6309 inspektime** respektivisht:

- Për tregtimin e PMB-ve **1566** inspektime
- Për tregtimin e MMSHB-ve **1951** “
- Për tregtimin e plehrave **2041** “
- Për tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij **751** “

Gjate kryerjes se kontroleve zyrtare për subjektet te cilat nuk kane zbatuar kërkesat ligjore janë marre masat administrative te parashikuara ne legjislacionin ne fuqi përkatësisht:

- Paralajmërimë **161**
- Gjoha gjithsej **54** me vlerë **3.645.000** lekë
- Bllokime produkti **362.82** kv dhe **4611.4** litra;

nga këto:

- ✓ PMB: **15** kg dhe **6** litra;
- ✓ MMSHB: **34** kv farë mistri dhe **91.25** kv farë qepujke;
- ✓ Plehra: **4605.4** litra dhe **223.05** kv;
- ✓ Produkte duhani: **14.37** kv;
- Asgjësim produkti (fara): **339.945** kv;

Gjate këtyre inspektimeve janë evidentuar problematika kryesisht në lidhje me :

- mungon emërtimi EC-Fertilizers, në ambalazhin bazë

⁵Te gjithë subjektet qe kane si aktivitet importimin,prodhimin dhe tregtimin e inputeve bujqesore

⁶Produktet e Mbrojtjes se Bimeve(PMB), materiali mbjellës e shumezues bimor, si dhe plehrat e Përdorimit per Bujqesine.

- mungesë të etiketës në gjuhën shqipe, plehrat tregtohen në kushte të pa përshtatshme magazinimi.
- Gjatë inspektimeve për tregtimin e PMB-ve në disa raste janë evidentuar produkte të pa regjistruara në Republikën e Shqipërisë.
- Ne disa raste pas analizimit të farave treguesit cilësor të tyre⁷ kanë qene ne normën e lejuar

Por në fakt ka edhe disa probleme serioze që impaktojnë drejtpërsëdrejti në garantimin e fermerit shqiptar për cilësinë e inputeve bujqësore përkatësisht:

- në harkun kohor të dy vjetëve nga ISUV⁸ nuk është realizuar asnjë analizë përse i përket produkteve të mbrojtjes së bimëve, gjë që komprometon jo vetëm realizimin me rigorozitet të kontrolleve zyrtare por edhe cilësinë e këtyre produkteve
- gjatë kontrolleve zyrtare të kryera nga AKU inspektorët marrin mostra të MMSHB⁹ (fare) për analizimin e treguesve cilësor të tyre. Marrja e mostrës nga inspektorët e DRAKU, kryhet në bazë të “Planit vjetor të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe marrjes së mostrave” si dhe bazuar në Ligjin Nr. 10433, date 16/06/2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”¹⁰ në rastet kur inspektori e sheh të nevojshme.

Por vazhdimisht jemi njoftuar nga DRAKU për vonesa në kthimin e përgjigjeve të analizave nga ESHFF¹¹.

- Marrja e këtyre mostrave ka një rëndësi të veçantë për të garantuar fermerin shqiptar për treguesit cilësor të farave, por edhe respektimi i afateve të analizimit dhe kthimit të përgjigjes përcaktojnë vlerën reale të këtij procesi, pasi komformiteti apo jo i analizave të produktit, impakton drejtpërsëdrejti në vendimmarrjen e AKU jo vetëm për subjektin por edhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme për produktin.¹²
- Gjithashtu në bazë të planit vjetor me bazë risku si dhe në zbatim të planeve të veprimit në subjektet që vendosin në treg plehra të përdorimit për bujqësinë përgjatë harkut kohor të dy viteve, 2016-2017 janë marrë gjithsej **193 mostra zyrtare** të cilat janë dërguar për analizim në laboratorin e QTTB Fushë Krujë. Nga sa më sipër arrijmë në konkluzion se, në të gjitha rastet e mostrave të analizuara nga laboratorin për treguesit cilësor të gjitha kanë rezultuar konform kërkesave që do të thotë se **në vendin tonë janë importuar plehra me tregues cilësor konform certifikatës së analizave që shoqëron plehun;**

🚩 Në zbatim të detyrave funksionale për vitin 2018 sektori ka realizuar:

⁷Fuqi mbirese, energji mbirese, pastertia e fares, lageshtia.

⁸Laboratori i vetëm në vendin tonë në të cilin realizohen analizat për treguesit cilësor të produkteve të mbrojtjes së bimëve

⁹materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

¹⁰Neni 38, pika 1 Nëse është e nevojshme për qëllimin e inspektimit, inspektorët kanë të drejtë të marrin, pa pagesë, mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve dhe t’ia nënshtrojnë ato ekzaminimit apo analizave

¹¹ Laboratori pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidaneve si laboratorij i vetëm për kryerjen e analizave zyrtare

¹²Kthimin në vendin e origjinës apo asgjësimit të produktit

- Koordinimin dhe unifikimin e procedurave të kontrolleve zyrtare me bazë risku si dhe praktikave të inspektimit në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe inpueteve bujqësore.
- Për një kontroll me rigoroz lidhur me verifikimin e treguesve cilësor të plehrave gjatë periudhës Maj-Qershor 2018 e cila përkon edhe me kohën më intensive të mbjelljes së kulturave bujqësore, shërbimeve agroteknike dhe përdorimit masiv të plehrave, nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU në bazë të një plani ju dha detyrë 12 Drejtorive Rajonale të AKU të marrin mostra për analiza zyrtare për plehrat “Ure” dhe “Nitrat Amoni”.

Nga Drejtoritë Rajonale të AKU u morën gjithsej 38 mostra përkatësisht: 18 mostra për plehun “URE” dhe 20 mostra për plehun “Nitrat Amoni”. Mostrat u dërguan për analizim në laboratorin e referencës të Qendrës së Transferimit të Teknologjive në Fushë-Krujë. Pas analizimit dhe kthimit të përgjigjes nga laboratoritë të 38 mostrat të plehrave “Ure” dhe Nitrat Amoni” rezultuan konform.

Inspektimet e kryera sipas llojit të aktivitetit për vitin 2018

Nga raportimet e DRAKU për inspektimet sipas llojit të aktivitetit për periudhën janar - dhjetor 2018 janë kryer gjithsej **4673** inspektime përkatësisht:

- | | | |
|---|-------------|------------|
| • Për tregtimin e PMB-ve | 1146 | inspektime |
| • Për tregtimin e MMSHB-ve | 1526 | “ |
| • Për tregtimin e plehrave | 1298 | “ |
| • Për tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij | 703 | “ |

Për operatorët e biznesit që gjatë inspektimeve në vitin 2018 janë konstatuar shkelje ligjore janë marrë këto masa administrative përkatësisht:

- Paralajmërimet 117
- Gjoha 90 gjithsej, me vlerë 882100 lekë
- Bllokime produkti 30.608 ton dhe 293 litra;
- Asgjësim produkti 40.906 ton dhe 319 paketa duhani
- Ndërprerje aktiviteti për 2 subjekte në aktivitetin tregtim me pakicë të PMB-ve.

Nga të dhënat e tabelës së më sipërme, si dhe duke e krahasuar me vitin 2017 rezulton se kemi një trend rritës në dhënien e masës administrative ”gjobë” për operatorët e biznesit që gjatë inspektimeve janë konstatuar shkelje të legjislacionit në fuqi përkatësisht: nga 54 masa administrative “gjobë” me vlerë 3. 645. 000 lekë të mara në vitin 2017, për vitin 2018 janë marrë

gjithsej 87 masa administrative me “gjobë” në vlerën 8. 921. 000 lekë edhe pse për vitin 2018 janë kryer 1700 inspektime më pak.

Gjatë vitit 2018 sektori ka përgatitur vlerësuar dhe përcjellë kërkesat për licencim gjithsej 115 kërkesa nga këto 75 kërkesa janë miratuar dhe 40 kërkesa janë refuzuar.

Referuar të dhënave për planin e marrjes dhe analizimit të mostrave për vitin 2018 rezulton se: nga DRAKU janë planifikuar për tu analizuar gjithsej 374 mostra përkatësisht:

- ✓ 33 mostra për analizimin e treguesve cilësor të PMB-ve nga laboratorin e ISUV;
- ✓ 53 mostra për analizimin e MMSHB për pastërti fitosanitare nga laboratorin e Departamentit të mbrojtjes së Bimëve;
- ✓ 191 mostra për analizimin e treguesve cilësor të farave në laboratorin e ESHFF
- ✓ 97 mostra për analizimin e treguesve cilësor të plehrave në laboratorin e QTTB Fushë-Krujë.

Sipas raportimeve ka rezultuar se nga DRAKU janë marrë dhe dërguar në laborator 390 mostra përkatësisht:

- ✓ 15 mostra për analizimin e treguesve cilësor të PMB-ve nga laboratorin e ISUV;
- ✓ 36 mostra për analizimin e MMSHB për pastërti fitosanitare nga laboratorin e Departamentit të mbrojtjes së Bimëve;
- ✓ 218 mostra për analizimin e treguesve cilësor të farave në laboratorin e ESHFF
- ✓ 121 mostra për analizimin e treguesve cilësor të plehrave në laboratorin e QTTB Fushë-Krujë.

Pas analizimit nga laboratorët respektive ka rezultuar që:

- ✓ Nga 33 mostra të planifikuara për analizimin e PMB-ve nga ISUV për vitin 2018 nuk u krye asnjë analizë. Nga AKU u dërguan 15 mostra për analizim por nga ISUV jo vetëm nuk u krye analizimi i këtyre mostrave por nga ISUV u dërgua shkresë me nr.458/1Prot, date, 19.06.2018 për mos dërgimin e mostrave për analizimin e PMB.
- ✓ 36 mostra për analizimin e MMSHB për pastërti fitosanitare nga laboratorin e Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve (ISUV) **rezultuan konform.**
- ✓ Nga 218 mostra për analizimin e treguesve cilësor të farave në laboratorin e ESHFF, **199 prej tyre rezultuan konform dhe 19 Jo konform.**
- ✓ 121 mostra për analizimin e treguesve cilësor të plehrave në laboratorin e QTTB Fushë-Krujë **rezultuan konform**

Problematikat e evidentuara nga sektori gjatë vitit 2018

Nga ana e sektorit për kryerjen e detyrave në zbatim të legjislacionit me të cilin operon janë evidentuar disa problematika përkatësisht:

Mos kryerja nga ISUV e analizave të PMB, bëri të mundur mos realizimin e zërit (analizë të PMB-ve) si dhe kontrollin e cilësinë e PMB-ve të vendosura në treg në bazë të planit vjetor të marrjes dhe analizimit të mostrave me bazë risku, për vitin 2018 të miratuar nga ministri.

Gjatë inspektimeve të kryera janë hasur probleme përsa i përket etiketimit të plehrave, ku në disa raste ka mungesë të etiketës në gjuhën shqipe, plehrat tregtohen në kushte të pa përshtatshme magazinimi.

Për problematikat e konstatuara nga sektori është sugjeruar të merren masa për zbatimin me rigorozitet të kërkesave ligjore për plehrat e përdorimit për bimësinë nga inspektorët e PIK me qëllim eliminimin e këtij fenomeni.

Detyrë jo pak e rëndësishme në kryerjen e detyrave funksionalë që ka sektori i MBIB është dhe marrja dhe dërgimi i mostrave zyrtare për analizë në laboratorët e referencës. Por që të kryhet kjo detyrë siç parashikohet në legjislacion duhet me pa tjetër që të disponohen dhe mjetet e marrjes së mostrës, garantimi dhe transportimi i tyre. Aktualisht në 12 DRAKU nuk disponohen mjete si për marrjen e mostrave, transportimin e tyre ashtu dhe për garantimin e sigurisë (pajisje për kodifikim). Për përmirësimin e logjistikës për marrjen, kodifikimin e mostrave dhe dërgimin në laborator nga ana e sektorit MBIB në planin financiar për vitin 2019 janë parashikuar të blihen 13 komplete me pajisjet e domosdoshme për marrjen e mostrave si dhe mjete për garantimin e tyre.

KONTROLI PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE INPUTET BUJQËSORE GJATE 6 MUJORIT TË PARË 2019

Nga të dhënat 6 mujore të raportuara nga DRAKU rezulton se nga 2362 inspektime të planifikuara në planin vjetor të inspektimeve me bazë risku për 6 mujorin e parë të vitit 2019 janë realizuar gjithsej 2122 inspektime të programuara ose 90 % të planit.

Për më tepër informojmë se nga sektori MBIB në total janë kryer gjithsej 2339 inspektime ose 99.61% të krahasuar me numrin e inspektimeve të planifikuara.

Nga sa më sipër, arrijmë në konkluzion se realizimi i inspektimeve të programuara në masën 90.4 % të planit ka ardhur si rezultat i mungesës së inspektorëve në disa DRAKU si: Kukës, Fier, Berat, Tiranë, Shkodër.

Theksojmë faktin se për mos realizimin e inspektimeve dhe analizimin e mostrave sipas planit për 6 mujorin e parë të vitit 2019 në qarkun e Kukësit arsye kryesore është mungesa e inspektorëve të mbrojtjes së bimëve për një periudhë të gjatë kohore. Aktualisht në këtë qark nuk ka asnjë inspektor të mbrojtjes së bimëve në një kohë që në organikën e miratuar nga KM janë miratuar dy inspektorë, problem i cili është ngritur nëpërmjet e-mailit gjithë hierarkisë drejtuese në AKU. Gjithashtu, në mos realizimin 100 % të planit të inspektimeve

dhe marrjes së mostrave kanë ndikuar edhe mungesa e disa inspektorëve në DRAKU-t e sipërcituara.

Në zbatim të detyrave funksionale për 6 mujorin e parë referuar Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së Nr.5 datë, 31/01/2019, “Për intensifikimin e inspektimeve në subjektet me aktivitet tregtimin e fidanëve frutor , agrumeve, ullirit, hardhive etj. me qëllim garantimin e fermerit shqiptar për fidanë të certifikuar dhe standardizuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi” për periudhën 04 Shkurt – 05 Mars 2019 nga sektori i MBIB në DRAKU u realizua plan veprimi për intensifikimin e inspektimeve në subjektet me aktivitet tregtimin e kulturave drufrutore.

Në zbatim të këtij urdhëri **gjatë periudhës 04.02-5.03.2019** , nga DRAKU rezulton janë kryer gjithsej **69 inspektime**.

Për operatorët e biznesit që gjatë inspektimeve janë konstatuar shkelje ligjore janë marrë masat administrative përkatësisht:

- ✓ **8 gjoba me vlerë 950.000 lekë.**
- ✓ **1 “Ndërprerje e plotë aktiviteti”.**

Theksojmë faktin se masat administrative të pasqyruara në zbatim të Urdhrit të sipërcituar janë të pasqyruara në tabelën përmblledhëse inspektimeve dhe masave administrative të mara.

INSPEKTIMET E KRYERA SIPAS LLOJIT TË AKTIVITETIT

Nga raportimet e DRAKU për inspektimet sipas llojit të aktivitetit për 6 mujorin e parë 2019 janë kryer gjithsej 2339 inspektime përkatësisht:

- **510** inspektime për PMB.
 - **793** inspektime për MMSHB.
 - **692** inspektime për Plehrat e Përdorimit për Bimësinë.
 - **344** inspektime për përpunimin industrial, dhe/ose prodhimin e produkteve të duhanit, tregtimin të duhanit dhe produkteve të tij.
- Masat administrative të marra nga Sektori i Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore për periudhën Janar-Qershor 2019 janë përkatësisht:
- ✓ Paralajmërimet **31**
 - ✓ Gjoba **23** me vlerë **2608000**lekë;
 - ✓ Bllokim të tregimit të produkteve **19.8 ton (fara) + 15 litra PMB + 0.02 Ton plehra.**
 - ✓ Asgjësim **49 ton** (fare misri me tregues të ulet cilësor)

KËRKESAT PËR LICENCIM

Gjatë vitit 2018 sektori ka përgatitur vlerësuar dhe përcjellë kërkesat për licencim gjithsej 56 kërkesa nga këto 38 kërkesa janë miratuar dhe 18 kërkesa janë refuzuar.

ANALIZIMI I MOSTRAVE NGA LABORATORËT RESPEKTIVË

- Nga raportimet e DRAKU rezulton se nga 170 mostra të mara për analizimin e treguesve cilësor të inputeve bujqësore rezulton se : **170 prej tyre rezultuan konform dhe 5 mostra rezultuan Jo konform dhe 26 janë në proces analizimi**
- Përsa i përket analizimit të PMB-ve nga ISUV për vitin 2019 Ju informojmë se: Referuar shkresës me Nr.366 Prot, datë 8.4.2019 ardhur nga ISUV me lëndë: “*Kthim përgjigje në lidhje me Draft planin kombëtar të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe marrjes së mostrave për vitin 2019*”, rezulton se nga laboratorit i ISUV mundësohet kryerja e analizave vetëm për 5 lëndë aktive të PMB. Për këtë arsye për vitin 2019 nga 36 mostra të planifikuara për analizimin, e PMB mund të analizohen vetëm 11 mostra që do të thotë mos realizim të planit me rreth 70% të analizave.
- Për analizimin e PMB për 6 mujorin e parë janë dërguar në laborator 24 mostra dhe deri në periudhën raportuese nga laboratorit i ISUV nuk është kryer asnjë përgjigje.

PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA

Nga ana e sektorit për kryerjen e detyrave në zbatim të legjislacionit me të cilin operon janë evidentuar disa problematika përkatësisht:

- Mos kryerja nga ISUV e të gjithë analizave të PMB të planifikuara për vitin 2019.
- Mos realizimin e inspektimeve dhe marrjen e mostrave sipas planit për periudhën Janar-Qershor 2019 në qarkun e Kukësit për mungesë të inspektorëve të mbrojtjes së bimëve për një periudhë të gjatë kohore.

Për përmirësimin e punës për të ardhmen mendojmë se duhet organizuar puna në këto drejtime:

- **Rritja e cilësisë të burimeve njerëzore**, me qëllim edukimin dhe trajnimin, e të gjithë inspektorëve të sektorit të MBIB për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit me të cilin operon si dhe njohjen me legjislacionin shtesë, nëpërmjet moduleve të trajnimit të përgatitura nga sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së.
- **Ngritja në një nivel të lartë të kontrollit mbi inputet bujqësore** për të bërë të mundur garantimin e fermerit shqiptar për treguesit cilësor të tyre.
- **Sensibilizimi i vazhdueshëm i operatorëve të biznesit që operojnë në fushën e mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore** me shkresa të personalizuara në rastet e ndryshimeve të akteve rregullative në fuqi apo daljen e akteve të reja nënligjore të reja me qëllim

njohjen me ndryshimet dhe shtesat që ka pësuar kuadri ligjor në fuqi, të cilat më pas janë dhe detyrime për zbatim nga ana e tyre.

- **Përmirësimi i mënyrës së funksionimit, konsolidimit të procedurave dhe proceseve të inspektimit nëpërmjet portalit e-inspektim** duke reflektuar saktë dhe në kohë reale të të gjithë ndryshimeve të legjislacionit me të cilin operon sektori
- Vazhdimi i zhvillimit dhe modernizimit të infrastrukturës, logjistikës etj, me qëllim përmirësimin e cilësisë së inspektimeve dhe krijimin e kushteve lehtësuese për grupet e inspektimit në teren.
- Takime të vazhdueshme me koordinatorët e të gjithë DRAKU me qëllim evidentimin e problematikave të hasura në rajonet e tyre dhe diskutimi i përbashkët me qëllim implementimin me korrektësi të bazës ligjore.

- Rritjen e bashkëpunim ndërinstitucional të vazhdueshëm me:

- ❖ Me sektorin Përgjegjës të Mbrojtjes së Bimëve në Ministrinë e Bujqësisë.

- Për listën e PMB të regjistruara në Republikën e Shqipërisë (të përditësuar);
- Për listën e regjistrimit të Plehrave për Përdorim për Bimësinë (të përditësuar);
- Për problemet e ndryshme të karantinës fitosanitare;

- ❖ Me Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve (ESHFF) për dërgimin zyrtarisht të:

- Katalogut Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve (të përditësuar) .
- Regjistrin e furnizuesve, në cilësinë e prodhuesve të MMSHB (të përditësuar)
- Për dërgimin në kohë të përgjigjeve për analizat zyrtare të farave.

- ❖ Me QTTB dhe ISUV për:

- Për dërgimin në kohë të përgjigjeve për analizat zyrtare të plehravepër përdorim për bimësinë.
- Për dërgimin në kohë të përgjigjeve për analizat zyrtare tëPMB-ve
- Për dërgimin në kohë të përgjigjeve për analizat zyrtare fitosanitare.

- ❖ Me Agjencinë Kombëtare të Duhan-Cigareve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor,

- Për koordinimin ndërinstitucional për kontrollin e tregtimi të duhanit dhe produkteve të tij.